



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
SHOQËRIA “ILLYRIAN GUARD” SH.A.
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E TEKNOLOGJISË

Nr ____Prot

Tiranë, më ____/____/2026



SPECIFIKIME TEKNIKE

E-mail zyrtar Illyrian Guard Sh.A



QERSHOR 08, 2026

1. HYRJE

Përfituesi / Autoriteti Kontraktues
Autoritet Kontraktues: Illyrian Guard Sh.A.

1.1. Të Përgjithshme

Këto specifikime teknike hartohen nga grupi i punës bazuar në urdhërin e administratorit nr.993 datë 05.06.2026 “Për Ngritjen e Grupit të punës për argumentimin e nevojave, hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “E-mail zyrtar @illyrianguard.al”, kërkesës nr. 1352 Prot., datë 26.05.2026 me lëndë “Kërkesë për nisjen e procedures së prokurimit me objekt “E-mail zyrtar @illyrianguard.al” dhe argumentimit të nevojave dërguar me email nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit datë 08.06.2026 .

Baza ligjore që mundëson realizimin e kësaj procedure prokurimi mbështetet në kuadrin ligjor dhe rregullator , si më poshtë:

- Ligji nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike” i ndryshuar me ligjin Nr. 90/2023 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”
- Ligji nr. 124/2024 “ Për Mbrojtjen e të dhënave personale”
- VKM Nr. 177, datë 04.04.2019 “Për krijimin e shoqërisë Illyrian Guard Sh.A.”
- Ligji nr. 162 datë 23.12.2020 për prokurimin publik i ndryshuar
- Vendim nr. 285, datë 19.5.2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar
- Ligji Nr. 54/2024 “ Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”

Qëllimi i këtij shërbimi është sigurimi dhe implementimi i një platforme moderne të postës elektronike zyrtare për Illyrian Guard Sh.A., bazuar në Microsoft 365 Business Standard, me qëllim garantimin e komunikimit institucional të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas. Nëpërmjet këtij shërbimi synohet krijimi i një infrastrukture të centralizuar për menaxhimin e email-eve zyrtare me domenin @illyrianguard.al, rritja e nivelit të sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave, mundësimi i bashkëpunimit dhe produktivitetit të stafit përmes shërbimeve cloud, si dhe sigurimi i mbështetjes teknike, migrimit të të dhënave ekzistuese dhe administrimit të platformës në përputhje me standardet ligjore dhe teknologjike në fuqi.

Operatori ekonomik duhet të ofrojë paketën **Microsoft 365 Business Standard**, duke përfshirë:

1. Licenca zyrtare të Microsoft 365 Business Standard, me të drejtë përdorimi për një periudhë minimale prej 12 muajsh.
2. Shërbime cloud të përfshira:
 - Exchange Online (email profesional)
 - Microsoft Teams (bashkëpunim në kohë reale)
 - SharePoint Online dhe OneDrive for Business (500 GB-1 TB për përdorues)
3. Mbështetje teknike për migrimin e të dhënave ekzistuese në platformën Microsoft 365.
4. Konfigurim i **Microsoft 365 Admin Center**, me politika sigurie dhe autentikimi shumëfaktorësh (MFA).
5. Siguri dhe përputhshmëri me standardet ISO dhe GDPR.

3. Garanci për mbështetje teknike

- Të ofrojë mbështetje teknike të nivelit të parë dhe të dytë në gjuhën shqipe, gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.
- Të ofrojë SLA (Service Level Agreement) për kohën e reagimit dhe zgjidhjes së incidenteve.
- Të ofrojë plan trajnimi dhe dokumentacion përdoruesi për stafin teknik dhe përdoruesit fundorë.

Aspekte të tjera që duhet të kërkojnë:

1. **Përdorimi i domenit ekzistues të institucionit** për adresat e emailit në Exchange Online.
2. **Migrim i email-eve historike dhe dokumenteve** nga sistemi aktual në Microsoft 365 (nëse është e nevojshme).
3. **Testim dhe validim funksional** pas përfundimit të konfigurimit.

Specifikimet teknike të Microsoft 365 Business Standard

1. Shërbimi i Postës Elektronike: Exchange Online

- **Kutia e postës:** 50 GB për përdorues
- **Dërgesa e bashkëngjitjeve:** deri në 150 MB
- **Emri i personalizuar i domain-it:** mundësi për të përdorur domenin tuaj të personalizuar (p.sh., )
- **Sinchronizimi i kalendarëve dhe kontakteve:** në të gjitha pajisjet dhe platforma
- **Akses nëpërmjet platformave:** Windows, macOS, iOS, Android dhe në ueb

2. Siguria e Postës Elektronike

- **Encryption TLS:** Për dërgesa të sigurta mes serverëve
- **Microsoft Purview Message Encryption:** Për mesazhe të koduara dhe kontroll të përmbajtjes (si pengimi i përhapjes së email-eve ose vendosja e datës së skadencës)
- **Exchange Online Protection (EOP):** Filtrimi i spam-it, phishing-ut dhe malware-it para se ato të arrijnë në kutinë tuaj të postës
- **Safe Links & Safe Attachments:** Skanojnë lidhjet dhe bashkëngjitjet për përmbajtje të dëmshme në kohë reale

- **Multi-Factor Authentication (MFA):** Kërkon një hap verifikimi shtesë gjatë hyrjes për të parandaluar aksesin e paautorizuar
- **Politika të aksesit të kushëzuar:** Lejojnë menaxhimin e aksesit në email bazuar në kushte të caktuara si vendndodhja, lloji i pajisjes ose niveli i rrezikut
- **Data Loss Prevention (DLP):** Skanojnë email-et për informacion të ndjeshëm dhe i ndihmojnë përdoruesit të shmangin dërgimin e të dhënave të ndjeshme jashtë organizatës
- **Audit Logs:** Gjurmimi i aktiviteteve të email-eve për qëllime sigurie dhe përputhshmërie

3. Menaxhimi i Email-eve

- **E-mail** te jetë i dedikuar për kompaninë Illyrian Guard (emër.mbiemër@illyrianguard.al)
- **Microsoft 365 Admin Center:** Për menaxhimin e përdoruesve, politikave të sigurisë dhe konfigurimeve të email-eve
- **Rregulla e transportit:** Për të automatizuar veprime të tilla si ridrejtimi i email-eve, filtrimi i përmbajtjes ose aplikimi i politikave të sigurisë
- **Politika të ruajtjes:** Për të zbatuar rregulla automatike për ruajtjen ose fshirjen e email-eve për të përmbushur kërkesat rregullatore

4. Integrimi dhe Bashkëpunimi

- **Microsoft Teams:** Për komunikim në kohë reale, thirrje video dhe bashkëpunim në grupe
- **OneDrive për Biznes:** 500 GB-1 TB hapësirë ruajtjeje për çdo përdorues për ruajtjen dhe ndarjen e dokumenteve
- **SharePoint:** Për krijimin e intranet-eve dhe faqeve të ekipeve për ndarjen e informacionit dhe bashkëpunimin
- **Microsoft Loop:** Për krijimin e hapësirave bashkëpunuese për mendime dhe planifikim

5. Përputhshmëria dhe Kërkesat e Sistemit

- **Pajisjet e mbështetura:** PC, Mac, tableta dhe pajisje mobile (Windows, iOS, Android)
- **Versionet e mbështetura të Sistemit Operativ:**
 - **Windows:** Windows 10 ose më i ri
 - **macOS:** Një nga tre versionet më të fundit të macOS
 - **iOS/iPadOS:** Dy versionet më të fundit të iOS/iPadOS
 - **Android:** Katër versionet më të fundit të Android
- **Memoria:**
 - **Windows:** 4 GB RAM (2 GB për versionin 32-bit)
 - **macOS:** 4 GB RAM
 - **Android:** 1 GB RAM
- **Hapësira në Disk:**

- **Windows:** 4 GB hapësirë të disponueshme
- **macOS:** 10 GB hapësirë të disponueshme në formatin HFS+ (macOS Extended)

5. Aplikacione desktop, web dhe mobile

- **Microsoft Word, Excel, PowerPoint, Outlook, OneNote:** Versione të plota për desktop, web dhe mobile, të cilat mund të instalohen deri në 5 pajisje për përdorues.
- **Microsoft Publisher dhe Access:** Disponohen vetëm për PC, duke ofruar mundësi për krijimin e materialeve të dizajnuara dhe menaxhimin e bazave të të dhënave.

KOMISIONI PËR HARTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE FONDIT LIMIT